# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6089
E hënë, 17 gusht 2020
çmimi 0.40 €


## Pezullohen punimet në rrugën Deçan - Plavë

FAQE 4-5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ANALISTËT POLITIKË E KOMENTOJNË TAKIMIN E 2 SHTATORIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË NË SHTËPINË E BARDHË FAQE 3

# ANALISTËT: KOSOVA TA KUPTOJË DREJT PËRKUSHTIMIN AMERIKAN PËR DIALOGUN

Njohësit e rrethanave politike nuk kanë pritje të mëdha nga takimi i 2 shtatorit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Analisti Imer Mushkolaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në këtë takim mund të arrihet vetëm ndonjë marrëveshje ekonomike në mes të dy vendeve, ndërsa Shkodran Ramadani dyshon se në takim mund të ketë ndonjë hap substancial përpara. Sipas tyre, Kosova duhet ta kuptojë drejt përkushtimin amerikan në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë



FLET PËR "EPOKËN E RE", SOKOL XHAFA

## MBI 45 MILIONË EURO BORXHI NDAJ KRU 'PRISHTINA'



Ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv i KRU "Prishtina", Sokol Xhafa, ka thënë se kjo kompani është duke u ballafaquar me probleme të shumta. Ai ka theksuar se një nga problemet më të mëdha janë borxhet. Në këtë kontekst, Xhafa ka thënë se niveli i borxhit të konsumatorëve ndaj KRU "Prishtina" kap shifrën e mbi 45 milionë eurove, ku afërsisht 40 milionë euro janë borxhe nga amvisëria.
"Borxhet gjatë vitit 2020, në periudhën e pandemisë, janë në vlerë prej 2.25 milionë eurove, ndërsa pjesa tjetër e borxheve janë që nga pas lufta", ka thënë Xhafa FAQE 8

## STATISTIKA TË PANDEMISË COVID NË KOSOVË: 11 416 RASTE POZITIVE, 401 TË VDEKUR, 7 191 TË SHËRUAR DHE 3 824 RASTE AKTIVE FAQE 7

## OPINION

BJERI GREKUT! F. 11

Shkruan:
Edi RAMA



## AKTUALE

BIE NUMRI I TË BURGOSURVE DHE TË PARABURGOSURVE, SHKAK PANDEMIA F. 6

HOTI SHËROHET NGA KORONAVIRUSI, SOT DEL NË ZYRË F. 7

SPECIALJA FTON PËR INTERVISTIM ISH-USHTARIN E UÇK-së, SADRI SELIMI F. 6



## EKONOMI

ODA E HOTELERISË DHE E TURIZMIT KËRKON ULJEN E TVSH-së NGA 18 NË 8 PËR QIND F. 9

PASURIA E "DYSHIMTË" E ZYRTARËVE SHTETËRORË F. 9

KRASNIQI KËRKON MBËSHTETJEN E UNDP-së PËR PUNËSIMIN E 600 TË DIPLOMUARVE NËPËR NDËRMARRJE PRIVATE F. 9

## SPORT

SOT DIHET KLUBI IM I RI, ËSHTË NGA MESI I TABELËS F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

## Meta, thirrje qeverisë: Bëni tamponin falas për qytetarët në Kakavijë

Tiranë, 16 gusht (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar në lidhje me situatën e shkaktuar në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës. Përmes një postimi profilin e tij në "Facebook", Meta ka shkruar se qytetarët e ndodhur në këtë pikë kufitare nuk mund të trajtohen si njerëz pa atdhe dhe pa shtet. "Qytetarët shqiptarë, të cilët prej ditësh ndodhen në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës, në kushte tejet të vështira dhe në prag të një krize humanitare, nuk mund të trajtohen si njerëz pa atdhe dhe pa shtet", ka shkruar Meta. Meta i bën thirrje qeverisë shqiptare të marrë të gjitha masat dhe të kryejë falas tamponin e Covid-19 për qytetarët. "Përsëris thirrjen e fortë drejtuar qeverisë shqiptare për të qëndruar pranë qytetarëve dhe për të marrë të gjitha masat, për informimin me transparencë, realizimin falas dhe në vendin ku ndodhen të tamponëve për Covid-19. Kontaktet me Greqinë të jenë konstante dhe vetëm në funksion të një zgjidhjeje të menjëhershme. Aktet e forcës janë të papranueshme! I kërkoj autoriteteve greke, që në respekt të frymës së fqinjësisë së mirë dhe lidhjeve të forta tradicionale mes dy popujve, të bëjnë të pamundurën për zgjidhjen e situatës, imazhet e së cilës turpërojnë të dyja vendet. Çdo qytetar i republikës së Shqipërisë meriton të trajtohet me dinjitet!", ka shkruar Meta.



# LSDM- BDI: Parimisht kemi arritur marrëveshje për qeverinë



Shkup, 16 gusht - LSDM-ja e Zoran Zaevit dhe Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) i Ali Ahmetit presin të arrijnë marrëveshje për koalicion qeveritar ditëve të ardhme, duke u shprehur të vetëdijshëm për urgjencën dhe nevojën për konsolidimin e institucioneve pas zgjedhjeve. Ashtu si ditëve të kaluara, pa shpalosur më shumë detaje, dy partitë kanë konfirmuar se janë duke vazhduar takimet konstruktive të punës në nivelin e sekretarëve të përgjithshëm për të siguruar një qeveri të qëndrueshme me mandat 4 vjeçar. Përmes një komunikate të përbashkët nga këto dy parti është thënë se shpërndarja e përgjegjësive sipas departamenteve në koalicionin e ardhshëm është duke u zhvilluar dhe se ky është një proces në të cilin është bërë përparim i mirë dhe është arritur marrëveshje parimisht. "Përsërisin se do të propozojnë drejtues të përshtatshëm të institucioneve që do të zbatojnë programin në mënyrë të suksesshme. Ndërsa paralelisht palët po punojnë në harmonizimin e programit të qeverisë së ardhshme, e cila sipas tyre, do të fokusohet në ekonominë, drejtësinë, barazinë dhe integrimin. Ndonëse socialdemokratët dhe integristët tashmë i kanë vendosur parimet e koalicionit, nuk tregojnë në çfarë drejtimi janë negociatat për atë se kush do të jetë kryeministri i ardhshëm, nëse dhe si do ta ndajnë mes vete këtë post", kanë njoftuar LSDM-ja dhe BDI-ja. Lideri i LSDM-së, Zoran Zaev të enjten ka marrë mandatin për formim të qeverisë dhe shumicës parlamentare. Nëse nuk arrin që ta bëjë këtë brenda afatit 20-ditësh, mandati do t'i kalojë liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski.

# Ende nuk dihet si do të fillojë viti i ri shkollor në Maqedoninë e Veriut

Shkup, 16 gusht - Akoma nuk ka asgjë konkrete se si do të fillojë ky vit shkollor për nxënësit e Maqedonisë së Veriut, nëse ata do të kthehen ose jo në bankat e shkollës. Nga dikasteri i arsimit thonë se gjendja epidemiologjike do të diktojë veprimet që do të ndërmerren. Në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Sëmundje Ngjitëse në Maqedoninë e Veriut, në bankat e shkollës në shtator pritet të ulen vetëm nxënësit e klasës së parë dytë dhe tretë, afërsisht fëmijët deri në moshën 10 vjeçare, përderisa nxënësit e tjerë rekomandohet që mësimin ta ndjekin online, megjithëse kanë shtuar se ky propozim për të ndjekur mësimin në distancë nuk i përfshinë të gjitha shkollat në komuna të ndryshme të shtetit. Jakim Nedellkov, kryetar i Sindikatës së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se në rend të parë është shëndeti i nxënësve dhe arsimtarëve, megjithëse shton se jo të gjitha shkollat në rajone të ndryshme të vendit kanë kushte të njëjta, andaj sipas tij, mësimi në shkolla të ndryshme të vendit, duhet përshtatur me rrethanat që imponon gjendja epidemiologjike. Ndërsa ekspertët e arsimit kanë thënë se rrethanat që ka imponuar koronavirusi me mësimin online do të lënë pasoja afatgjata tek nxënësit si në aspektin e nxënies së mësimit, por edhe ndërtimin e karakterit të tyre. Avzi Mustafa, pedagog, për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se mësimi online po dëmton gjendjen emocionale të nxënësve, si dhe ka zbehur në masë të madhe raportet emocionale nxënës-nxënës dhe nxënës mësimdhënës.



## Arrestohen 3 persona në Durrës, tentuan të kalojnë me autobus 26 kg marijuanë

Durrës, 16 gusht - Një sasi prej 26 kg marijuanë në formë çokollate është sekuestruar nga policia në pikën e kalimit kufitar në portin e Durrësit. Tre persona kanë përfunduar në pranga, dy shoferët e autobusit dhe menaxheri. Gjatë kontrollit të një autobusi që shkonte drejt Italisë, sasia e lëndës narkotike është konstatuar brenda një kove me bulmet. "Si rezultat i kontrolleve të shtuara dhe analizës së riskut të bërë nga Policia Kufitare, u kalua për kontroll të detajuar në vijën e dytë, një autobus që kryente linjën Durrës-Itali. Gjatë kontrollit në një kovë me bulmet, u kon-



statuan brenda saj pako me lëndë narkotike. Menjëherë janë njoftuar specialistët për hetimin e narkotikëve në DVP Durrës, ku pas kontrollit te imtësishëm u gjet dhe u sekuestruan një sasi rreth 26 kg lëndë narkotike marijuanë, në formë çokollate. Në përfundim të veprimeve të para hetimore të kryera nga Specialistët për hetimin e narkotikëve, u bë arrestimi i dy shoferëve të autobusit dhe i menaxherit. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua lënda narkotike, 1 automjet si dhe 6 aparatë celular. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Durrës, për veprime të mëtejshme", ka njoftuar Policia e Durrësit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Analistët politikë e komentojnë takimin e 2 shtatorit në mes të Kosovës dhe Serbisë në Shtëpinë e Bardhë

# Analistët: Kosova ta kuptojë drejt përkushtimin amerikan për dialogun



**Njohësit e rrethanave politike nuk kanë pritje të mëdha nga takimi i 2 shtatorit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Analisti Imer Mushkolaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në këtë takim mund të arrihet vetëm ndonjë marrëveshje ekonomike në mes të dy vendeve, ndërsa Shkodran Ramadani dyshon se në takim mund të ketë ndonjë hap substancial përpara. Sipas tyre, Kosova duhet ta kuptojë drejt përkushtimin amerikan në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 KORRIK - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë folur për pritjet nga takimi i 2 shtatorit, ku Kosova dhe Serbia në Shtëpinë e Bardhë do ta vazhdojnë dialogun për normalizim të marrëdhënieve në mes tyre.

Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nga ky takim mund të pritet vetëm ndonjë marrëveshje ekonomie në mes të dy vendeve. "Takimi i 2 shtatorit do të jetë konfirmim i përkushtimit për arritjen e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi, por mund të arrihet edhe ndonjë marrëveshje e karakterit ekonomik" ka thënë ai.

Mushkolaj ka bërë me dije se Kosova duhet ta kuptojë drejt këtë përkushtim amerikan ndaj këtij procesi. Sipas tij, institucionet e Kosovës duhet ta kapitalizojnë interesin amerikan në këtë proces. "ShBA-ja e ka bërë të qartë se përgjegjësia kryesore për arritjen e marrëveshjes politike i takon Brukselit por, natyrisht, roli i ShBA-së është thelbësor. Kosova duhet ta kuptojë drejt këtë përkushtim amerikan dhe duhet ta kapitalizojë sa më shumë në interes të vetin", ka thënë Mushkolaj.

Më pesimizëm t për takimin ka shprehur analisti politik Shkodran Ramadani. Ai ka vlerësuar se këtë proces e ka komplikuar aktivizimi i Gjykatës Speciale. "Dyshoj se në takimin e radhës në Uashington mes Kosovës e Serbisë do të ketë ndonjë hap substancial përpara. Situata është komplikuar qëkur Grenelli ka deklaruar se ShBA-ja do të përqendrohet në çështje ekonomike dhe qëkur Gjykata Speciale ka filluar aktivitetin e vet. Po ashtu, qëkur aspekti politik - aspekti qendror i dialogut - ka rifilluar të gravitojë drejt orbitës së BE-së, vështirë se mund të presim angazhim përmbajtjesor e vendimtar nga Uashingtoni, sidomos tash që zgjedhjet në ShBA po afrohen dita-ditës", ka shkruar Ramadani në profilin e vet në "Facebook".

Sipas tij, në këtë proces problem është edhe Qeveria e Kosovës, e cila është e brishtë për të marrë vendime të rëndësishme. "Përveç këtyre, Qeveria e Kosovës ndërkohë është shumë e brishtë dhe nuk mund të marrë ndonjë vendim serioz. Marrëveshja në mes të Izraelit dhe Emirateve Arabe krijon sadopak një mjedis më inkurajues, por kontesti Kosovë - Serbi është shumë më i rëndë se ai në mes të Emirateve dhe Izraelit. Kësisoj, nuk mund të tërhiqet paralele serioze mes tyre", është shprehur Ramadani.

Ndërsa Instituti Demokratik i Kosovës ka vlerësuar se është i domosdoshëm që në Kosovë të ndërtohet konsensus politik para se të shkohet në Uashington për dialog me Serbinë më 2 shtator. "Në kuadër të procesit të normalizimit, Kosova dhe Serbia janë duke zhvilluar takime të vazhdueshme të cilat kanë për synim arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme. Pavarësisht prej gatishmërisë dhe mbështetjes nga spektri politik për procesin përmbyllës të dialogut, mungesa e konsensusit politik lidhur me përfaqësimin e Kosovës në bisedime, po vazhdon ta karakterizojë pozicionin e saj negociues", është thënë në komunikatën e KDI-së.

KDI-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që sa më parë t'i shtojë përpjekjet për arritjen e konsensusit sa më të gjerë në mes të spektrit politik lidhur me të gjitha çështjet e ndërlidhura me dialogun për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Ne vlerësojmë që kjo çështje duhet të trajtohet përtej kalkulimeve politike ditore andaj, si partitë në pushtet, edhe ato në opozitë, duhet të tregojnë përkushtim dhe konstruktivitet për t'i tejkaluar pengesat në arritjen e pajtueshmërisë politike rreth procesit, para takimit të paralajmëruar në Uashington. Çdo vonesë në këtë drejtim rrezikon ta dëmtojë pozitën e Kosovës në bisedime si dhe marrëdhëniet e saj me partnerët ndërkombëtarë", është thënë në komunikatë.

I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, të premten i ka ftuar liderët e Kosovës dhe Serbisë për takimin e radhës në Uashington. Ai ka bërë me dije se ndihet i lumtur që këto dy vende do të takohen në Shtëpinë e Bardhë për negociata. Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës e kanë mirëpritur takimin, duke e falënderuar ShBA-në për angazhimin e saj në këtë proces.

Sipas tyre, Kosova dhe Serbia në këtë takim do të negociojnë si dy shtete të pavarura. I vetmi që është shprehur kritik ndaj këtij takimi ka qenë ish-kryeministri, lideri i LV-së, Albin Kurti. Përmes një postimi në "Facebook", Kurti e ndërlidhi ftesën e këtij takimi me zgjedhjet presidenciale në ShBA që pritet të mbahen në nëntor. "Në këtë kontekst duhet të shihet edhe 2 shtatori si datë e paralajmëruar e negociatave ndërmjet Kosovës e Serbisë në Uashington D. C. Ish-ambasadori amerikan në Berlin dhe ish u. d. i drejtorit të Inteligjencës Nacionale, Richard Grenell, e do një sukses të orëve të fundit në politikën e jashtme", ka shkruar Kurti.

Takimi i parë i këtij lloji në Shtëpinë e Bardhë ishte paraparë të mbahet më 27 qershor, por për shkak të publikimit të aktakuzës së Gjykatës Speciale për presidentin Hashim Thaçi, ky takim ishte anuluar.



Qeveria e Kosovës kërkon ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë që prek zonën e Manastirit të Deçanit

# Pezullohen punimet në rrugën Deçan - Plavë

Pas reagimeve të shumta, janë pezulluar punimet në rrugën Deçan - Plavë që prek zonën e Manastirit të Deçanit. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar një gjë të tillë, duke thënë se e mbështet shqyrtimin e të gjitha mundësive ligjore dhe praktike në terren për ta kompletuar këtë rrugë që e lidh Republikën e Kosovës me Republikën e Malit të Zi

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar që të pezullohen punimet në rrugën Deçan - Plavë që prek zonën e Manastirit të Deçanit. Përmes një komunikate për media, kryeministri ka vlerësuar se mbështet shqyrtimin e të gjitha mundësive ligjore dhe praktike në terren për ta kompletuar këtë rrugë që e lidh Republikën e Kosovës me Republikën e Malit të Zi. "Kryeministri Hoti e vlerëson rëndësinë jetike që ka kjo rrugë për qytetarët e kësaj ane dhe përtej saj, megjithatë duhen respektuar legjislacioni në fuqi i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Duke e ditur ndikimin e drejtpërdrejtë të kësaj rruge në ekonominë dhe në cilësinë e jetës së banorëve të Komunës së Deçanit, kryeministri Hoti e mbështet shqyrtimin e të gjitha mundësive ligjore dhe praktike në terren për ta kompletuar këtë rrugë që e lidh Republikën e Kosovës me Republikën e Malit të Zi", është thënë në komunikatën e Zyrës së Kryeministrit.

Kryeministri Hoti ka ritheksuar përkushtimin e plotë të Qeverisë dhe të popullit të Kosovës për t'i ruajtur dhe për t'i respektuar objektet sakrale si një vlerë e përbashkët e trashëgimisë së pasur shpirtërore të Republikës së Kosovës. Reagimi i kryeministrit Hoti ka ardhur një ditë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, bëri me dije se Beogradi do të kërkojë "pezullim urgjent dhe të përhershëm të punimeve të ndërtimit në zonën e mbrojtur të Manastirit të Deçanit" nga përfaqësuesit e Prishtinës dhe ndërmjetësuesit evropianë në takimin e ardhshëm në Bruksel. Për këtë çështje, edhe komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, Michele Risi, ka vizituar të shtunën Deçanin dhe është takuar me kryetarin e kësaj komune, Bashkim Ramosaj. Risi dhe Ramosaj kanë biseduar për situatën e përgjithshme në zonën e veçantë të mbrojtur të Deçanit. Komandanti Risi ka takuar, po ashtu, edhe Peshkopin Sava Janjiq në Manastirin e Deçanit.

"Në të dy takimet u diskutua për situatën e përgjithshme në zonë, duke marrë parasysh ndikimin e veçantë në siguri të punimeve në rrugën R108 që shtrihet në afërsi të Manastirit të Deçanit", është thënë në njoftimin për medie të KFOR-it. Ndërsa kryepeshkopi i Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq, ka thënë se është pro ndërtimit të rrugës Deçan - Plavë, bazuar në ligjet e Kosovës. Përmes një reagimi në profilin e vet në "Facebook", Janjiq ka thënë se Ligji për Zonën e Mbrojtur Speciale është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ky ligj qartë saktëson se cilat aktivitete brenda zonës janë të lejuara dhe cilat nuk janë. "Nuk e kam as qëllimin më të vogël t'u përgjigjem 'fjalëve të rrugës' dhe vetëm do të kisha vënë re që disa njerëz qartazi nuk i lexojnë ligjet e veta. Ligji për Zonën e Mbrojtur Speciale është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ky ligj qartë saktëson se cilat aktivitete brenda zonës janë të lejuara dhe cilat nuk janë. Aty saktësohet çfarë është e ndaluar pa ndonjë mundësi diskutimi dhe çfarë mund të diskutohet. Rrugët transite (sidomos rrugët ndërkombëtare) që kalojnë nëpër zona rurale, me fjalë të tjera, zona të pabanuara (dhe zona e Deçanit është për më tepër pjesë e Parkut Kombëtar) janë të ndaluara", ka shkruar Janjiq, duke shtuar se ndërtimi i kësaj rruge është i ndalur me ligj. "Mbi të gjitha, ne kurrë nuk kemi qenë kundër rrugës Deçan - Plavë (Mal i Zi). Problem gjithmonë ka qenë ndërtimi i një rruge të tillë nëpër Zonën e Mbrojtur Speciale, që është veprim i ndaluar sipas ligjit dhe analizave ligjore të misioneve të BE-së dhe OSBE-së në Kosovë. Thjesht, kjo çështje nuk mund të diskutohet, nëse ne pajtohemi që ta respektojmë sundimin e ligjit", ka shkruar Janjiqi.



## Ramosaj e quan të “çmendur” udhëheqësin e Manastirit të Deçanit

Edhe Komuna e Deçanit ka bërë me dije se përkohësisht janë ndërprerë punimet në këtë rrugë, duke vlerësuar se ato do të rifillojnë prapë. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, e ka quajtur të çmendur Sava Janjiqin, kryemurgun e Manastirit të Deçanit, i cili ka kërkuar ndërprerjen e punimeve. “Kur i ‘çmenduri’ udhëheq Manastirin e Deçanit, çmenduritë sa vijnë e shtohen për komunën tonë, e sidomos kur të çmendurit i dëgjohen dëshirat, rezultatet janë më tepër se shoviniste. Kam arsyetuar e argumentuar shumë, që objektivat tona janë krejtësisht paqësore. Ndërtimi i Rrugës ‘R-108’, e cila kalon në zonën e veçantë të mbrojtur, në thelb e ka vetëm konceptin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. Vetëm kaq! Me pasurinë që Zoti ia fali kësaj komune duam t’i rrisim fëmijët tanë me një standard më të lartë ekonomik. Në këtë përpjekje nuk do të ndalem derisa të jem në punë si kryetar i komunës”, ka shkruar Ramosaj në profilin e vet në “Facebook”.

Edhe Nisma Socialdemokrate, Dega në Deçan, është shprehur e shqetësuar me situatën e fundit në Deçan dhe ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Kjo parti ka kërkuar reflektim nga faktori ndërkombëtar në Kosovë, në të njëjtën kohë i ka bërë thirrje që të mos bie preh e politikave dyfytyrëshe të Janjiqit. “Ne i bëjmë thirrje pushtetit vendor në Deçan, që t’i vazhdojë punimet në rrugën Deçan - Plavë, sepse ky segment është i një rëndësie te veçantë jo vetëm për Kosovën e Malin e Zi, por për gjithë rajonin e Ballkanit. Ne dënojmë gjuhën urrejtëse të përfaqësuesit të Manastirit të Deçanit, Sava Janjiç, i cili me gjuhën dhe veprimet e tij, është duke e dëmtuar rëndë situatën e sigurisë dhe atë të përgjithshme në Komunën e Deçanit”, është thënë në reagimin Nismës.

Për Nismën Socialdemokrate politizimi i rrugës Deçan - Plavë është i papranueshëm, duke shtuar se rruga Deçan - Plavë, përveç se është e rëndësishme për gjithë rajonin e Ballkanit, ajo ka një rëndësi të madhe edhe për zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit. “Ne kërkojmë që rruga Deçan - Plavë të vazhdojë të ndërtohet dhe i bëjmë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që t’i shtojë fondet për investime për kryerjen e këtij projekti”, përfundon reagimi.



Fillimi i punimeve të rrugës Deçan - Plavë (R-108), rrugë kjo që e lidh rajonin e Dukagjinit me atë të Plavës dhe Gucisë, ka filluar më 2018. Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2016 kishte marrë vendim, sipas të cilit, i njihet e drejta e pronësisë Manastirit të Deçanit mbi 24 hektarë tokë. Por, ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga Komuna e Deçanit.

Zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë në vazhdimësi kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.



# Syla: Fëmijët e dëshmorëve të kenë përparësi në konkursin për rekrutë dhe kadetë në FSK

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Deputeti i AAK-së, Gazmend Syla, ka thënë se është i papranueshëm fakti që fëmijët e dëshmorëve apo të luftëtarëve të UÇK-së nuk kanë prioritet në konkursin për rekrutë dhe kadetë të Ushtrisë së Kosovës. Me këtë rast, Syla ka kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes që fëmijët e dëshmorëve të jenë pjesë e Ushtrisë së Kosovës. Ai në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në “Facebook” ka kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes që të nxjerrë akt nënligjor, në mënyrë që fëmijëve të dëshmorëve t’u lehtësohet mënyra e të qenit pjesë e Ushtrisë së Kosovës. “E pa pranueshme që Ministria e Mbrojtjes të mos nxjerrë ndonjë akt nënligjor, që fëmijëve të dëshmorëve apo luftëtarëve të iu lehtësojë që të bëhen pjesë e ushtrisë tonë. Qoftë edhe vetëm një pikë në konkurse, në shenjë respekti të sakrificës së prindërve të tyre në luftën për liri. Kjo nuk ndodhë as për kadetët e rinj e as për rekrutët. Paramendoni në shtete të tjera, kategorive të tilla iu bëhet oferte në shtëpi, nga rekrutuesit, sepse ka vlerë të madhe nëse në ushtri shërbejnë fëmijët e luftëtarëve e dëshmorëve. Asnjëherë nuk jam për diskriminim të dikujt. Por, në shumë sfera, tradita ka rol kryesor. E më së shumti në shërbimin ushtarak”, ka shkruar Syla.



# Më 1 tetor Qendra e Studentëve do të jetë gati për studentët banues

PRISHTINË, 16 GUSHT - Qendra e Studentëve do të jetë gati që të presë banues të rinj që nga 1 tetori si çdo vit tjetër. Madje konviktet e kësaj qendre janë duke u rinovuar e pastruar, pasi ishin përdorur për krantinimin e të kthyerve nga jashtë Kosovës deri në mesin e muajit qershor. Drejtori i kësaj qendre, Fatmir Sfishta, e ka quajtur fat të madh mbylljen e karantinës, pasi që kanë filluar projektet sa i përket renovimit të objekteve. Ai ka thënë se Qendra e Studentëve është duke u angazhuar për përmirësimin dhe ofrimin e kushteve për një ambient sa më të pastër dhe të rehatshëm për studentët banues. Sipas tij, në këtë qendër ka filluar të bëhet edhe pastrimi i dyshekëve në të gjitha dhomat e konvikteve. “Në momentin që është mbyllur Qendra e Studentëve si karantinë ne i kemi dezinfektuar të gjitha hapësirat e jashtme dhe të brendshme, mirëpo zakonisht në fillim të çdo viti akademik ne bëjmë edhe një herë dezinfektimin e çdo hapësire. Tash kemi filluar edhe një projekt për pastrimin e dyshekëve që kanë qenë të përdorur gjatë kohës së pandemisë”, ka thënë ai, duke shtuar se çdo projekt i planifikuar do të kryhet deri më 15 shtator. “Në kushte normale studentët kanë nisur të vijnë në Qendrën e Studentëve më 1 tetor, mirëpo këtë vit për shkak të pandemisë nuk varet nga ne. E jona është që të bëhemi gati që më 1 tetor të fillojë viti akademik dhe të vijnë studentët, por varet nga institucionet e tjera që viti akademik të vazhdojë në rrethanat normale. Çdo projekt është planifikuar të kryhet deri më 15 shtator”, është shprehur Sfishta për “EO”.



# Bie numri i të burgosurve dhe paraburgosurve, shkak pandemia

PRISHTINË, 16 GUSHT - Pandemia Covid-19 ka ndikuar që të ketë numër më të vogël të të burgosurve dhe të ketë ndërprerje të paraburgimit. Ky numër ka rënë për gati 200 prej fillimit të shfaqjes së këtij virusi në Kosovë. Më 16 mars, kur Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) kishte marrë vendim që të kufizohet aktiviteti brenda gjykatave, këto institucione kanë trajtuar vetëm çështje urgjente dhe, si pasojë, ishin anuluar seancat që nuk paraqesin urgjencë. Ndërkohë që gjatë vitit 2020, mbi 970 persona janë në pritje të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Kështu ka thënë drejtori i Shërbimit Korrektues i Kosovës (ShKK), Nehat Thaçi, i cili në një intervistë për “Kosovapress”, ndër të tjera, ka folur edhe për mungesën e ligjit që mund të amnistojë apo pezullojë dënimet në kohë të përkohshme. Për këtë Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të



Torturës muaj më parë i është drejtuar Komisionit për Legjislacion si dhe shefave të grupeve parlamentare me propozimin për inicimin e ndryshimeve ligjore në procedurë të përshpejtuar në mënyrë që të mundësohet lirimi i përkohshëm apo amnistia për të dënuarit në kohën e pandemisë. “Tash kemi rënie të të burgosurve, pasi që Kosova nuk ka një ligj që mund të amnistojë apo mund të lirojë, apo pezullojë dënimet në kohë të përkohshme, edhe pse ka qenë tentativë asokohe nga Presidenca, ministrja dhe nga grupet parlamentare dhe nuk ka arritur që të procedohet ky ligj. Janë aktivizuar aktorët e tjerë siç është Paneli për Lirim me Kusht dhe Presidenca. Kështu që kanë qenë mjaft aktivë dhe kanë arritur t’i lirojnë Paneli për lirim me kusht disa prej të burgosurve. Në të njëjtën kohë ju e dini se edhe gjykatat kanë punuar me kapacitete të zvogëluara dhe vetëm raste urgjente. Prandaj edhe numri i të burgosurve dhe të paraburgosurve ka rënë në masë të dukshme, që rrjedhimisht ka lehtësuar punën tonë dhe menaxhimin e tyre”, ka deklaruar Thaçi.

Ndalesa e vizitave të familjarëve të të burgosurve, Thaçi ka thënë se ka qenë sfiduese për Shërbimin Korrektues, pasi kjo e ka bërë më të vështirë qëndrimin e tyre gjatë këtyre muajve në qendrat e paraburgimit dhe burgimit në Kosovë. “Zakonisht burgjet kanë pasur numrin e të burgosurve dhe të paraburgosurve rreth 1650-1670 sillemi zakonisht. Tash konkretisht, nëse nuk gaboj, në të gjithë statistikat e sotme është 1 423. Prandaj, gjatë kësaj pandemie kemi rënie të të burgosurve dhe të paraburgosurve”, është shprehur ai. Sipas tij, janë dy të burgosur dhe 26 zyrtarë korrektues të cilët janë infektuar me koronavirus deri më tani, ku prej tyre 12 janë ende po qëndrojnë në vetizolim. Si shkak i rritjes së numrit të rasteve me këtë pandemi, Shërbimi Korrektues i Kosovës nga 11 korriku ka ndaluar sërish vizitat për të gjithë të burgosurit. Thaçi ka treguar se gjatë këtij viti janë rreth 970 persona në pritje të ekzekutimit të vendimit. “Sipas statistikave, gjatë vitit 2020 diku 970 persona janë në pritje të ekzekutimit të vendimit. Do të thotë, bëhet fjalë për vendimin përfundimtar për shkak të vendimit përfundimtar të Gjykatës së Apelit apo të ngjashme. Kështu që, vlerësoj se gjykatat edhe gjatë kohës së pandemisë kanë vepruar shumë mirë derisa kanë arritur t’i marrin 970 vendime për burgim të cilat ende nuk kanë marrë formën e vendimit të prerë. Prandaj ne presim, jemi të përgatitur që t’i presim të dënuarit e tjerë”, ka thënë Thaçi.

# Specialja fton për intervistim ish-ushtarin e UÇK-së, Sadri Selimi

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Ish-ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sadri Selimi, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale, në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Lajmin e ka dhënë bashkëluftëtari i tij, Safet Hasani, në një postim në llogarinë e vet në “Facebook”. Sot morëm lajmin se bashkëluftëtari ynë, që shërbyem së bashku në të njëjtën njësi ushtarake PU-ZOSh gjatë luftës së UÇK-së, Sadri Selimi, nga Vërrnica e Vushtrrisë, është ftuar nga Gjykata Speciale për krime lufte, në cilësinë e të dyshuarit. Ne jemi plotësisht të bindur për pastërtinë e Sadriut, për veprat e tij gjatë luftës dhe për tërë luftëtarët e UÇK-së. Ashtu siç dole faqebardhë gjatë luftës, ashtu të presim edhe të kthehesh nga kjo gjykatë fantome”, ka shkruar ai.

Hasani ka mallkuar për shumë breza ata spiunë që kritikojnë pjesëtarët e UÇK-së dhe luftën e shenjtë e UÇK-së. “Do të doja të dija, si po ndihen tani ata dëshmitarë parazitë (spiunë) që dëshmuan kundër pjesëtarëve të UÇK-së? A ju mjaftoi, o të mjerë, që për pak para dhe dokumentacionet e refugjatëve që i fituat, t’i akuzoni pjesëtarët e UÇK-së dhe luftën e shenjtë të UÇK-së? Qofshin të mallkuar për shumë breza ata spiunë që kritikojnë pjesëtarët e UÇK-së dhe luftën e shenjtë të UÇK-së!”, ka shkruar Hasani.



# Statistikat të pandemisë Covid në Kosovë: 11 416 raste pozitive, 401 të vdekur, 7 191 të shëruar dhe 3 824 raste aktive



Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë si pasojë e Covidit kanë vdekur 11 persona, duke e çuar në 401 numrin e përgjithshëm të vdekjeve. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 141 raste të reja me Covid-19 si dhe janë shëruar 230 persona. Ky institut ka theksuar se numri i përgjithshëm i rasteve pozitive në vendin tonë ka shkuar në 11 416, ndërsa i të shëruarave në 7 191. Sipas IKShPK-së, në Kosovë janë edhe 3 824 raste aktive me virusin "Korona"

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 16 gusht - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ië Kosovës (IKShPK) ka treguar se gjatë 24 orëve të fundit 11 persona kanë vdekur nga koronavirusi. Në njoftimin për media të IKShPK-së është thënë se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar nga virusi 230 pacientë, kurse janë shënuar 141 raste të reja me Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 440 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 141 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 11.416 raste nga 43 984 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 401 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 230 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 7 191 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 824", ka njoftuar instituti, duke treguar numrin e rasteve në nivel komunash. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 44 raste, komuna Gjilan 17 raste, komuna Pejë 14 raste, komuna Podujevë 9 raste, komuna Drenas 8 raste, komuna Ferizaj 6 raste, komuna Gjakovë 6 raste, komuna Mitrovicë 6 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Dragash 4 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Junik, Klinë, Obiliq, Prizren, Rahovec, Shtime dhe Skenderaj", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, të dielën ka vizituar laboratorin e mikrobiologjisë molekulare në IKShPK, ku ka thënë se në këtë laboratorë është duke u bërë një punë e shkëlqyer nga ekipi i ekspertëve të mikrobiologjisë, që krahasohet me laboratorët me të avancuar perëndimorë. "Ne së bashku po bëjmë përpjekje maksimale t'i rrisim kapacitetet brenda institucioneve shëndetësore publike që qytetarët në masë sa më të madhe të mund t'i bëjnë testet falas. Ditët e fundit kemi licencuar dhjetëra laboratorë privatë për kryerjen e testeve. Ju lutemi, përmbahuni rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Së bashku ia dalim!", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

### Haradinaj: Kosova është në rrugë të mirë të mposhtjes së pandemisë

Ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova është në rrugë të mirë të mposhtjes së pandemisë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe bizneseve është i panevojshëm. "Kosova është në rrugë të mirë të mposhtjes së pandemisë. Javët e fundit ndërgjegjësimi i qytetarëve po jep rezultate të mrekullueshme. Edhe më tutje mbes me qëndrimin se kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe bizneseve është i panevojshëm. Sëmundja do të mposhtet me kulturën tonë për të jetuar me të, duke bërë kujdes e duke ruajtur shëndetin tonë dhe të tjerëve. Pres që Kuvendi i Kosovës ta miratojë pakon e rimëkëmbjes ekonomike dhe uljen e tatimeve për bizneset e masa të tjera të nevojshme. Unë besoj se vendi ynë do të rimëkëmbet. Me politika të drejta, mobilizimin tonë, të bizneseve, të diasporës dhe me përkrahjen e aleatëve. Zoti e bekoftë Kosovën dhe popullin e saj!", ka shkruar Haradinaj.

## Kryeprokurori Lumezi, pozitiv me Covid-19

Kryeprokurori i Kosovës, Aleksandër Lumezi, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lajmi është bërë me dije nga zyra e tij përmes një njoftimi për media. Është bërë me dije se tashmë Lumezi është vetizoluar. "Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njofton opinionin publik se kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, dje e ka bërë testin për Covid-19, me ç'rast ka rezultuar pozitiv. Nga momenti i testimit, kryeprokurori Lumezi është vetizoluar", ka njoftuar Zyra e Prokurorit të Shtetit. Sipas njoftimit, gjendja shëndetësore e kryeprokurorit të Shtetit është stabile dhe ai është duke e marrë trajtimin e duhur mjekësor.

## Hoti shërohet nga koronavirusi, sot del në zyrë

Kryeministri Avdullah Hoti gjendet në izolim tash e dy javë, meqenëse ka rezultuar pozitiv për Covid-19. Për gjendjen shëndetësore të Hotit ka dhënë detaje këshilltari i tij për media, Xhavit Beqiri. Sipas Beqirit, gjendja e Hotit është e mirë dhe se pritet që nga sot (e hënë) të dalë në zyrë. "Gjendja e kryeministrit është e mirë. Ai pritet të dalë në zyrë, por do t'ju njoftojmë për detaje", ka thënë Beqiri për mediat vendore.

Flet për "Epokën e re", Sokol Xhafa

# Mbi 45 milionë euro borxhi ndaj KRU 'Prishtina'



Ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv i KRU "Prishtina", Sokol Xhafa, ka thënë se kjo kompani është duke u ballafaquar me probleme të shumta. Ai ka theksuar se një nga problemet më të mëdha janë borxhet. Në këtë kontekst, Xhafa ka thënë se niveli i borxhit të konsumatorëve ndaj KRU "Prishtina" kap shifrën e mbi 45 milionë eurove, ku afërsisht 40 milionë euro janë borxhe nga amvisëria. Po ashtu, ai ka thënë se sfida për këtë kompani mbeten pandemia dhe kushtet klimatike. "Borxhet gjatë vitit 2020, në periudhën e pandemisë, janë në vlera prej 2.25 milionë eurove, ndërsa pjesa tjetër e borxheve janë që nga pas lufta", ka thënë Xhafa

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) "Prishtina", Sokol Xhafa, ka thënë se sfidat me të cilat është duke u përballur tani kjo kompani janë më të mëdhatë që nga paslufta. Në këtë bisedë për "Epokën e re", ai ka thënë se akumulimi i borxheve ndaj kësaj kompanie, situata pandemike dhe kushtet atmosferike janë sfidat kryesore me të cilat janë duke u ballafaquar. "Sfidat që po përballet kompania këtë vit janë më të mëdhatë që ka pasur ndërmarrja që nga paslufta, duke marrë parasysh situatën me pandeminë dhe situatën me thatësi në përgjithësi. Sigurisht situata me pandeminë ka ndikuar jashtëzakonisht shumë edhe në rritjen e borxheve nga konsumatorët", ka thënë Xhafa.

Në këtë kontekst, Xhafa ka treguar se borxhet e mbledhura ndër vite në KRU "Prishtina" kapin shifrën mbi 45 milionë euro, prej të cilave, sipas tij, rreth 40 milionë euro janë nga amvisëria. "Borxhet e akumuluara ndër vite në kompani janë në nivelin mbi 45 milionë euro. Përafërsisht 40 milionë euro janë borxhe nga amvisëritë", ka deklaruar Xhafa.

Më tutje, Xhafa ka treguar edhe për nivelin e borxheve të këqija, duke bërë me dije se vetëm gjatë përdhes së pandemisë shuma e borxheve ndaj KRU "Prishtina" kalon mbi dy milionë euro. "Borxhet gjatë vitit 2020, në periudhën e pandemisë, janë në vlerë prej 2.25 milionë eurosh. Pjesa tjetër e borxheve janë që nga pas lufta, në vazhdimësi", është shprehur Xhafa.

Ndërsa sa i përket rajonit më problematik në lidhje me borxhet, ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv i KRU "Prishtina" ka thënë se, për shkak të koncentrimit të konsumatorëve, Prishtina mbetet pjesa më problematike. "Sigurisht për shkak të territorit dhe koncentrimit të konsumatorëve, Prishtina prinë me borxhe, për të vazhduar me Podujevën, Obiliqin e kështu me radhë", ka thënë pos tjerash Xhafa.

Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur edhe për paralajmërimin e kësaj kompanie se nga 1 shtatori do ta fillojë procedimin e konsumatorëve borxhlinj në procedurë përmbarimore, për të cilën gjë ka thënë se do ta kenë parasysh gjendjen pandemike dhe se do të bëjnë prerje dhe të gjithë konsumatorët të cilët kanë detyrime ndaj kompanisë deri në muajin shkurt 2020, para kohës kur është shfaqur pandemia, do t'i procedojnë te përmbaruesit. "Që nga data 1 shtator do ta fillojmë procedimin e konsumatorëve borxhlinj në procedurë përmbarimore. Marrë parasysh situatën pandemike, do të bëjmë prerje dhe të gjithë konsumatorët të cilët kanë detyrime ndaj kompanisë deri në muajin shkurt 2020, dmth. para kohës kur është shfaqur pandemia, ne do t'i procedojmë në përmbarues, ndërsa nga muaji mars e këndej do ta shikojmë gjendjen dhe do të kursehen si konsumatorë. Por, edhe nëse lënda u shkon në procedurë përmbarimore, nuk do të thotë se konsumatorët mbesin pa ujë. Përveç kësaj, fatura mujore e ujit është simbolike në krahasim me shërbimet e tjera komunale (energji elektrike, TV apo të tjera)", ka thënë Xhafa.

## Oda e Hotelerisë dhe Turizmit kërkon uljen e TVSh-së nga 18 në 8 për qind



PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit e Kosovës (OHTK) ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta miratojnë vendimin për uljen e TVSh-së nga 18 për qind në 8 për qind për të gjitha bizneset e hotelerisë dhe gastronomisë. "Qeveria e Kosovës që nga data 27.06.2020 ka miratuar kërkesën e kamotshme të OHTK-së që të ulet TVSh-ja nga 18 për qind në 8 për qind për të gjitha bizneset e hotelerisë dhe gastronomisë, por kjo kërkesë ka mbetur të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Qeveria e ka pranuar këtë kërkesë dhe atë deri më datë 31.12.2021, ku do të jetë ndihmëse për këto biznese, andaj kërkojmë që sa më parë këtë vendim ta miratojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta votojnë këtë kërkesë për të mirën e hotelerisë dhe të gastronomisë", është thënë në komunikatën e nënshkruar nga Hysen Sogojeva, kryetar i OHTK-së.

# Pasuria e 'dyshimtë' e zyrtarëve shtetërorë

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka thënë se deklarimet e pasurisë të zyrtarëve shtetërorë jo gjithmonë janë të sakta. Ai ka theksuar se kjo agjenci nuk ka mekanizma për gjurmimin e prejardhjes së pasurisë së tyre. Havolli ka treguar se për verifikimin e prejardhjes së pasurisë tashmë janë duke përgatitur një ligj të ri për verifikimin e pasurisë së deklaruar të zyrtarëve shtetërorë



**Prishtinë, 16 gusht** - Verifikimi i prejardhjes së pasurisë së deklaruar të zyrtarëve të lartë shtetërorë në Kosovë vazhdon të mbetet mision i pamundur për shkak të mungesës së mekanizmave ligjorë, pohojnë përfaqësues të shoqërisë civile. Pamundësia e verifikimit të prejardhjes, sipas tyre, krijon dyshime se sa është reale dhe e ligjshme pasuria e deklaruar. Zyrtarët shtetërorë janë të obliguar për çdo vit ta deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK), proces ky të cilën tashmë e kanë përfunduar rreth 98 për qind prej tyre, tregojnë udhëheqës të kësaj agjencie.

Në regjistrin e deklarimit të pasurisë në këtë agjenci disa prej zyrtarëve shtetërorë kanë deklaruar vlera të mëdha të pasurive të luajtshme, të paluajtshme, si dhe para të gatshme në institucionet financiare, që në raste të caktuara shkon në miliona euro.

Drejtori i kësaj agjencie, Shaip Havolli, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se deklarimet e pasurisë të zyrtarëve shtetërorë jo gjithmonë janë të sakta. Por, agjencia, ka thënë Havolli, nuk ka mekanizma për gjurmimin e prejardhjes së pasurisë së tyre. Ai ka treguar se për verifikimin e prejardhjes së pasurisë tashmë janë duke përgatitur një ligj të ri për verifikimin e pasurisë së deklaruar të zyrtarëve shtetërorë.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2011 ka miratuar Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, në bazë të të cilit edhe përfundon procesi i deklarimit të pasurisë. "Bëhet fjalë për ligj të ri, por normal disa elemente të ligjit aktual do të merren, sepse është në kontiunitet në përmirësim të bazës ligjore. Me ligjin e ri ekzistojnë disa rregulla, norma se si do të verifikohet prejardhja e pasurisë. Ky tashmë është draftligj dhe shpresojmë që gjatë këtij viti ky projektligj të shkojë në qeveri", ka thënë Havolli.

Zyrtarët shtetërorë deklarojnë dhe e vlerësojnë sipas "dëshirës" vlerën e pasurisë së luajtshme, paluajtshme dhe shumën e parave të gatshme në Agjencinë Kundër Korrupsionit, thonë përfaqësues të shoqërisë civile, sipas të cilëve, kjo procedurë krijon hapësirë për dyshime për ligjshmërinë e pasurisë se tyre.

Arton Demhasaj, drejtor i Organizatës për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet - "Çohu", ka thënë se krijimi i bazës ligjore për këtë çështje kërkon përkushtim urgjent për shkak se disa nga zyrtarët shtetërorë kanë deklaruar pasuri në vlerë milionëshe që janë në mospërputhje më të hyrat e tyre vjetore. "Dhe këtu krijohet përshtypja se ata kanë pasuri të paligjshme ose të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Kështu që mendoj se ka hapësirë të madhe për t'u rishikuar baza ligjore në këtë aspekt. Duhet të krijohen mekanizma dhe dispozita ligjore që merren për verifikimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë", ka thënë Demhasaj.

Demhasaj ka theksuar se në kuadër të ligjit të ri duhet të mundësohet konfiskimi i pasurisë, nëse vërtetohet se pasuria e zyrtarëve është joligjore. Në Kosovë, ekziston Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Por, në bazë të këtij ligji, konfiskimi i pasurisë realizohet vetëm për personat e dënuar për ndonjë nga veprat penale me Kodin Penal të Kosovës. Për këtë, Demhasaj ka pohuar se autoritetet kompetente asnjëherë nuk kanë marrë seriozisht çështjen e ligjit civil, gjithmonë Kosova ka anuar nga modeli penal i konfiskimit të pasurive dhe për këtë vazhdimisht kjo çështje është treguar e dështuar.

Ndërsa në Ministrinë e Drejtësisë kanë thënë se "në kuadër të programit legjislativ të kësaj ministrie për vitin 2020 është paraparë edhe Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, i cili po trajtohet së bashku me Projektligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit". "Ministria e Drejtësisë, versionet e hartuara nga grupi punues, pjesë e të cilit janë përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit, pastaj përfaqësues nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial, partnerët strategjikë si dhe shoqëria civile, do t'i procedojë gjatë muajit shtator për konsultime, fillimisht paraprakisht, më pas me publikun, për t'u siguruar se procesi i hartimit dhe finalizimit të këtyre projektligjeve të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent", është thënë në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Përfaqësues të organizatave joqeveritare vazhdimisht kanë kërkuar që organet kompetente të merren me seriozisht me verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme pasi, sipas tyre, pjesa më e madhe e pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme në Kosovë është në duart e njerëzve të pushtetshëm dhe rrjedhimisht, theksohet se ka munguar vullneti që këta persona të ndiqen penalisht dhe si rezultat i tërë kësaj, nuk ka pasur mundësi që pasuria e tyre të konfiskohet.

# Krasniqi kërkon mbështetjen e UNDP-së për punësimin e 600 të diplomuarve nëpër ndërmarrje private

**Prishtinë, 16 gusht (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka zhvilluar një takim virtual me përfaqësues të UNDP-së në Kosovë nga të cilët ka kërkuar mbështetje në projektet për ndihmë bizneseve. Me këtë rast, ai ua ka prezantuar atyre një projekt konkret që përfshinë angazhimin e 600 të të diplomuarve nëpër biznese. Për realizimin e këtij projekti, Krasniqi ka thënë se do të kërkojë mbështetje edhe nga organizata të tjera ndërkombëtare. "Zhvillova sot një takim virtual me përfaqësues të UNDP-së në Kosovë me të cilët kam diskutuar për mundësinë e bashkëpunimit. Ata i informova për vështirësitë me të cilat po ballafaqohet Kosova, në veçanti bizneset në këtë kohë pandemie. Kërkova nga UNDP-ja mbështetje në projektet për ndihmë bizneseve duke ua prezantuar një projekt konkret që përfshinë angazhimin e 600 të diplomuarve nëpër biznese. Për realizimin e këtij projekti do të kërkojë mbështetje edhe nga organizata të tjera ndërkombëtarë e që bashkërisht ta realizojnë.



Përfaqësuesit e UNDP-së potencuan se mbështetja për aftësi dhe shkathtësi profesionale nuk ka munguar asnjëherë nga UNDP-ja", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

# Latifi premton mbështetje për fermerët e Rahovecit

RAHOVEC, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë dhe drejtori i Ekonomisë, kanë vizituar fabrikën për përpunimin dhe konservimin e perimeve "Apetiti" në Krushë të Madhe dhe qendrën grumbulluese të pemëve dhe perimeve "Agro Celina" në Xërxë.

Ai ka thënë se nga drejtori i "Apetitit", Kujtim Hoti, janë njoftuar në lidhje me procesin e përpunimit të perimeve, konkretisht prodhimin e ajvarit dhe turshive, produkte këto të cilat tash e sa kohë shiten në tregun vendor. "Z. Hoti, po ashtu, na informoi se në plan ka qenë që tashmë të fillohet edhe me eksport të këtyre produkteve vendore edhe në tregun evropian, por për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19, një plan i tillë nuk ka pasur mundësi të realizohet për këtë vit. Për vizitë ishim edhe në QG 'Agro Celina', ku u pritëm nga pronari, z. Feim Rexhepi, i cili na informoi se QG e frutave dhe perimeve 'Agro Celina', krahas eksportimit të vazhdueshëm të trangullit, ka filluar edhe eksportimin e specit 'Somborka'. Urova të dy pronarët dhe menaxhmentin e NPT 'Apetiti' dhe QG 'Agro Celina' për rezultatet e arritura deri më tani. I sigurova se në të ardhmen bashkëpunimi në mes të komunës dhe bizneseve, që janë storie suksesi, do të jetë edhe më i madh dhe në këtë pikë mbështetja nga Komuna e Rahovecit nuk do të mungojë asnjëherë", ka thënë Latifi.



# Komuna e Skenderajt bën të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor



SKENDERAJ, 16 GUSHT (ER) - Komuna e Skenderajt, nën udhëheqjen e kryetarit Bekim Jashari, në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që nxënësit e kësaj komune të mos e humbin procesin mësimor. Në këtë drejtim, Drejtoria e Arsimit, konkretisht drejtori Bekim Latifi, përmes platformës online, të organizuar nga "Kosova që duam", me përkrahjen e fondacionit "Friedrich Ebert Stiftung", ka mbajtur takimin me drejtorët e shkollave të Komunës së Skenderajt, me qëllim të koordinimit për fillimin e vitit shkollor. Në këtë takim online është diskutuar rreth alternativave rreth mësimit, ku deri më tani orientimi i Komunës së Skenderajt është që të shkohet me alternativën që parasheh që mësimi për nivelin e parë, nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë, si dhe klasa e dhjetë do të fillojë në shkollë, duke i respektuar të gjitha rekomandimet e dala nga institucionet shëndetësore. Ndërsa për klasat e tjera do të organizohet mësimi në distancë. Të gjithë drejtorët gjatë kësaj periudhe, deri më 1 shtator, do të angazhohen që të bëhen të gjitha përgatitjet që ky proces të fillojë në mënyrë sa më të mirë.

## Dezinsektohen hapësirat publike në Drenas dhe Komoran

DRENAS, 16 GUSHT (ER) - Pas të gjitha përgatitjeve të nevojshme nga ana e Komunës së Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, është kryer dezinsektimi i hapësirave publike në qendër të Drenasit dhe në Komoran. Projekti është realizuar nga kompania e kontraktuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë. Dezinsektimi i hapësirave publike ka për qëllim asgjësimin e insekteve të dëmshme si masë parandaluese e përhapjes së sëmundjeve infektive.





## 'Jetimat e Ballkanit' dhurojnë 300 pako me mish për familjet skamnore në Kamenicë

KAMENICË, 16 GUSHT (ER) - Shoqata "Jetimat e Ballkanit" kanë dhuruar 300 pako me mish për familjet me asistencë sociale në Kamenicë. Përmes Qendrës për Punë Sociale janë identifikuar 300 familjet përfituese të këtyre pakove. Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zaimi-Krasniqi, ka thënë se i është mirënjohëse kësaj shoqate që aktiviteti i saj human është i pranishëm edhe në Kamenicë. Ndërsa udhëheqësi i Qendrës për Punë Sociale, Rifat Hajdari, ka thënë se lista për familjet përfituese është përpiluar me kujdes nga stafi, duke u dhënë përparësi nënave vetushqyese.

# KU MBETËN ‘VIJAT E KUQE’?



Shkruan: Ferat SHALA

Zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë, ndër të tjera, janë karakterizuar nga një qëndrim pothuajse i të gjitha partive politike për të mos bërë koalicion me PDK-në. Ky qëndrim u artikulua zëshëm gjatë gjithë fushatës zgjedhor, por edhe pas përfundimit të zgjedhjeve dhe u shoqërua me togfjalëshin “vijat e kuqe”. Pra, ata thoshin se kishin “vija të kuqe” për PDK, për të mos hyrë në asnjë formë në një koalicion qeverisës, edhe pse PDK-ja pas zgjedhjeve ishte deklaruar vetë se nuk do të përfshihej në qeveri në asnjë lloj koalicioni. Në gjithë këtë kohë, partitë e pozitës dhe opozitës vazhduan me “diferencimin” e PDK-së. Sot gjërat kanë ndryshuar rrënjësisht. Partitë e koalicionit qeverisës e duan PDK-në në qeveri, ndërsa LV-ja kërkon votat e saj për ta rrëzuar qeverinë dhe asnjëra palë nuk përmend më “vijat e kuqe” dhe nuk mohon koalicionin në të ardhmen me PDK-në.

Çfarë po ndodh në të vërtetë?! A ka ndryshuar PDK-ja apo kanë ndryshuar partitë e tjera?! Ku mbetën “vijat e kuqe”? Ku mbetën parimet e trumbetuara aq shumë? Ku mbetën programet politike? Dhe, mbi të gjitha, ku mbeti premtimi që ua dhanë qytetarëve dhe elektoratit të tyre? Të gjitha këto pyetje janë në qendër të debatit politik të Kosovës së ditëve të sotme. Kjo situatë dhe ky ndryshim qëndrimesh që po na prezantohet sot, përfaqëson qartë normat morale e politike mbi të cilat funksionon politika në Kosovë në përgjithësi dhe, mbi të cilën, funksionojnë partitë e “vijave të kuqe” në veçanti. Në shikim të parë duket sikur përgjigjja në pyetjet e parashtruara më sipër është e komplikuar dhe se do të duhej një analizë e detajuar e shumë faktorëve dhe mendimeve. Por, në të vërtetë, kjo nuk është aq komplekse. Përgjigjja është e thjeshtë dhe krejt e qartë: kemi të bëjmë me hipokrizinë politike, diçka që në Kosovën e sotme është bërë standard dhe është kthyer në normë. Kjo qasje mashtron njerëz, ua merr votën, e përdorë atë për gjithçka vetëm kurrë jo në emër dhe për llogari të të cilëve është kërkuar dhe marr besimi i qytetarëve të Kosovës dhe të mirës së tyre. Sapo këto parti vijnë në pushtet harrojnë premtimet dhe atë shpirtin e “pastër” të para pushtetit. Këto parti e kanë sofistikuar hipokrizinë politike në atë masë saqë e kanë vendosur një pjesë të konsiderueshme të elektoratit në huti dhe lajthitje të thellë, duke iu pamundësuar që të dallojnë se kush është i miri dhe kush i keqi. E gjitha kjo shpërfaqë një të vërtetë të madhe dhe krejt të qartë: pa PDK-në nuk mund të ndodhin procese të mëdha dhe zhvillime pozitive për Kosovë. Të gjitha të tjerat janë mashtrime - me qëllimin e vetëm - për ta marrë pushtetin.

# BJERI GREKUT!



Shkruan: Edi RAMA

Kështu më shkruante një ndër disa “patriotë” të irrituar, që mësyjnë këto ditë me ajfon në këtë faqe, duke e komentuar situatën në Kakavi si të ishte fronti i ndonjë lufte shqiptaro-greke. “Vdiq një engjëll dhe ju hajduta merreni me shtëpira”, shkruante një mësymës tjetër, duke komentuar postimin e vizitës së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, sot në Xhafzotaj të Shijakut, ku ka nisur ndërtimi i 233 shtëpive për familjet që humbën çatinë në 26 nëntorin e shkuar. “Ju duheni djegur të gjallë o monstra që po i lini të vdesin vëllezërit tanë në Kakavi”, shkruante një Yllka, që uroj të jetë profili fallco i ndonjë harbuti me fejsbuk, e largqoftë jo një vajzë studente siç shfaqej aty. Po për çfarë t’i biem grekut(?), se kishte dalë edhe një komedian diku që kishte vënë kujën se “greku na ka ulur brekët!”… Në kufirin greko-bullgar të Kulatas, radha dje ishte plot 5 kilometra dhe askush në Bullgari nuk kërkon hapjen e ndonjë lufte bullgaro-greke, ashtu sikundër i njëjti problem shfaqet edhe në pika të tjera kufitare, ndërkohë që për shembull, në pikën kufitare të Kapikulesë në Turqi, numri i makinave në radhë ishte shtrirë 40 kilometra. Po edhe andej nuk janë dëgjuar as thirrje për luftë, as thirrje për djegie njerëzish të gjallë. Natyrisht që askush s’mund të jetë as i lumtur, as i paacaruar nervash duke pritur në karvane sfilitës nën diellin përvëlues, për të kaluar kufirin. Por as koha që jetojmë nuk është aspak normale dhe pavarësisht shumëkujt që e konsideron Covidin një sajesë të oligarkisë botërore, Covidi jo vetëm ekziston, po edhe i ka futur shtetet në lloj-lloj spiralesh shqetësuese, në përpjekjen për ta përballur kanosjen e tij. Kakavija nuk është as ndonjë përjashtim në këtë kohë të mallkuar dhe as ka ndonjë lidhje me ndonjë qasje a sjellje antishqiptare të fqinjëve tanë. Për më tepër pastaj, t’i turresh qeverisë e shtetit shqiptar, pse Greqia ka vendosur një regjim të ri kufitar në të drejtën e vet dhe jo vetëm për të huajt, po edhe për vetë grekët, është realisht e tepërt. Humbja e jetës së fëmijës që i preu rrugën autoambulancës ishte një tragjedi e dhimbshme sa s’ka dhe ne nuk do të mjaftohemi thjesht me ngushëllimet e sinqerta me fjalë që as nuk gjenden dot, për atë familje të goditur nga ajo fatkeqësi e tmerrshme. Por nuk është gjëkundi as kjo një arsye për të urryer fqinjin apo mallkuar shtetin. Unë nuk dua të justifikoj asgjë, sepse asgjë nuk ka këtu për të justifikuar, e për më tepër e kam treguar se kur është puna për të ngritur zërin në emër të Shqipërisë, nuk ia përtoj askujt dhe asnjëherë. Ama në këtë rast, nuk ka asnjë arsye “për t’i rënë grekut” dhe me palën greke kemi qenë e jemi non stop në komunikim, e ata kanë bërë e po bëjnë çfarë munden për ta lehtësuar lëvizjen, ndërkohë që kanë marrë vendimin të testojnë me tampon çdokënd, shqiptar, anglez, amerikan, kinez e madje edhe grek, që hyn në Greqi. Nga nesër madje, Greqia do të ketë kuota hyrjeje në çdo pikë kufitare dhe s’do lejojë askënd, në asnjë pikë, të hyjë përtej kuotës së caktuar. Prandaj kush shkon në Greqi, për më tepër që shumica dërrmuese e atyre që janë apo shkojnë drejt Kakavisë këto ditë, janë rezidentë në vendin fqinj, duhet të informohet si duhet dhe të mos kërkojë nga shteti shqiptar as arsyet pse shteti grek ka zgjedhur këtë strategji për të luftuar Covidin, as që të çajmë kufirin grek me forcë apo të “trashim zërin” ndaj Greqisë për një vendimmarrje sovrane e legjitime të shtetit grek, mbi regjimin antiCovid në kufijtë e vet. Ne, Shqipëria, nuk besojmë se tamponat në kufi për ata që hyjnë në vendin tonë, kanë ndonjë efekt real në luftën kundër Covidit dhe si ne ka plot shtete që nuk besojnë në këtë strategji. Por ama ka edhe plot shtete, që njësoj si Greqia kanë zgjedhur këtë strategji. Tani çfarë duhet të bëjmë ne, sipas “patriotëve” që nga llogorja e fejsbukut gjuajnë grekun e duan të na djegin të gjallë neve, “monstrat”, për situatën në Kakavi?! Ne duhet të bëjmë thjesht dhe vetëm atë që kemi bërë e po bëjmë. Asistencë përmes Forcave të Ushtrisë, Urgjencës Kombëtare, strukturave vendore, me gjithçka mundemi për njerëzit që po sfiliten në atë karvan rraskapitës dhe komunikim në vijimësi me palën greke në të gjitha nivelet – tanimë ata janë angazhuar me tre turne për të lehtësuar kalimin. Edhe njëherë, ka plot arsye për ta kritikuar çdo qeveri në botë, këtë tonën po e po, po për patriotizëm e për përkushtim ndaj njerëzve, në çdo ditë të keqe sidomos, kur pa dashjen e për fajin e askujt, na bie një hall i përbashkët mbi kokë, kësaj qeverie i vjen anash çdokush që merr përsipër ta akuzojë e ta mallkojë. Dhe kush do një shembull të thjeshtë për këtë – se ka shumë në fakt – le t’i kujtojë pak ditët e netët e pafundme pas tërmetit të 26 nëntorit kur u qëndruam njerëzve pranë si pjesë e familjes së tyre dhe le të shohë çdo ditë sot, se si po rilindin hap pas hapi, mbi gërmadhat e asaj tragjedie, shkollat e shtëpitë e reja, që s’do kenë krahasim me ato që u shkatërruan. Natyrisht detyrën po bëjmë, asgjë më shumë, por disave që ma kujtojnë këtë këtu në këtë faqe, a thua se kur bën detyrën ndaj popullit duhet të fshihesh e jo të jesh krenar, u kujtoj se të gjitha qeveritë, qysh se ka lindur shteti, për detyrën krijohen, por dallimin mes tyre e bën pikërisht niveli i kryerjes së detyrës.



# Erdogani: Turqia "nuk do të tërhiqet" nga ballafaqimi me Greqinë në Mesdhe

Ankara, 16 gusht - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka thënë se Turqia nuk do të tërhiqet para paralajmërimeve për sanksione dhe as para inkursioneve në një territor të cilin ajo e pretendon si të vetin në Detin Mesdhe, ku ajo dhe Greqia, anëtare e BE-së, janë mbërthyer në një ballafaqim mbi të drejtat për shpimkërkim në një territor të diskutueshëm. Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian (BE) kanë thënë të premten, pas një takimi të kërkuar nga Athina, se veprimet e Ankarasë ishin antagoniste dhe të rrezikshme.
Tensionet mes dy vendeve anëtare të NATO-s, Greqisë dhe Turqisë, janë shtuar këtë javë, pasi Turqia dërgoi një anije kërkimi, të shoqëruar nga anije luftarake, për të analizuar një zonë në Mesdheun lindor, mbi të cilën të dyja vendet kanë pretendime territoriale. "Ne nuk do të përulemi kurrë përballë banditërisë në pjesën tonë të territorit. Nuk do të dorëzohemi para gjuhës së sanksioneve dhe kërcënimeve", ka thënë presidenti Erdogan në qytetin verilindor të Rizës.
Anija e kërkimit "Oruc Reis", që ndodhet mes Qipros dhe ishullit grek të Kretës, do ta vazhdojë punën deri më 23 gusht, shtoi ai. Ajo është rrethuar nga fregatat greke dhe të mërkurën anije luftarake të të dyja palëve u përfshinë në një përplasje të lehtë. Marrëdhëniet mes Greqisë dhe Turqisë kanë qenë shpesh të mbushura me tensione. Mosmarrëveshjet kanë pasur të bëjnë që nga kufijtë e pjesëve të nënujoreve në det dhe hapësirës ajrore, e deri tek ishulli i ndarë në vija etnike i Qipros. Në vitin 1996 dy vendet pothuajse hynë në luftë lidhur me përkatësinë e disa ishujve të vegjël të pabanuar në Detin Egje.



# Vdes vëllai i presidentit Donald Trump



Nju Jork, 16 gusht - Robert Trump, vëllai i presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka ndërruar jetë të shtunën në moshën 71-vjeçare. "Me zemër të thyer ju njoftoj se ka ndërruar jetë vëllai im i mrekullueshëm, Robert. Ai nuk ishte vetëm vëllai im, por edhe miku im i ngushtë. Kujtimi për të do të jetojë në zemrën time përgjithmonë. Prehu në paqe!", ka njoftuar presidenti Trump.
Presidenti Trumpi kishte vizituar vëllanë në një spital në Nju Jork më 14 gusht, pasi ai ishte në gjendje të rëndë shëndetësore. Presidenti kishte një raport mjaft të ngushtë me vëllanë e tij të vogël, përkundër personaliteteve të ndryshme.
Rivali politik i presidentit Trump, kandidati për president në zgjedhjet e nëntorit në ShBA, Joe Biden, përmes një postimi në "Twitter" ka shprehur ngushëllime ndaj familjes Trump për humbjen e Robertit. "Zoti president, Jill (bashkëshortja) dhe unë u pikëlluam pas lajmit për vdekjen e vëllait tuaj Robert. E kuptoj dhimbjen e humbjes së një personi të dashur dhe e di se sa është e rëndësishme familja në momente sikur kjo. Shpresoj se e dini që lutjet tona janë me të gjithë ju", ka thënë Bideni.
Robert Trump kishte lindur më 1948 dhe ishte fëmija më i vogël në mesin e 5 fëmijëve të biznesmenit të patundshmërisë Fred Trump. Robert Trump kishte nisur karrierën në Wall Street, duke iu bashkuar më vonë Organizatës Trump si drejtues ekzekutiv.

# Mashtrime në zgjedhjet presidenciale, dhjetëra gazetarë të arrestuar në Bjellorusi

Minsk, 16 gusht - Organizatat e gazetarëve kanë njoftuar se autoritetet në Bjellorusi kanë arrestuar rreth 70 gazetarë, të cilët kanë raportuar për mashtrime në zgjedhjet presidenciale të kësaj jave dhe zemërimin pasues të publikut. Që nga e enjtja, 23 gazetarë mbeten në paraburgim, sipas Reporterëve pa Kufij, që ka cituar Shoqatën Bjelloruse të Gazetarisë. Sipas deklaratës, njerëzit që punonin si reporterë janë arrestuar në mënyrë të rastësishme, janë rrahuar dhe nganjëherë janë izoluar edhe për periudha të gjata. Ka raportime për 29 raste për dhunë policore ndaj gazetarëve, me të paktën shtatë lëndime të rënda. "Një persekutim i tillë i medies në Evropë është plotësisht i papranueshëm", ka thënë zëvendësdrejtoresha e Reporterëve pa Kufij, Catherine Monnet.




MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L

E rrallë

# Zbulohet ndikimi që ka Dielli për shkaktimin e tërmeteve



Aktiviteti diellor mund t'i influencojë tërmetet me magnitudë të lartë. Zbulimi mjaft i rëndësishëm shërben për t'i shpjeguar ato lëvizje të tokës që kanë intensitet më të lartë dhe është një hap i rëndësishëm për të qenë më pranë mundësisë për t'i parashikuar. Studiuesit e universiteteve dhe Institutit të Gjeofizikës në Itali kanë marrë në shqyrtim të gjitha statistikat e përftuara nga satelitët mbi aktivitetin diellor dhe ato të tërmeteve në Tokë në 20 vjetët e fundit. Kërkimet janë përqendruar mbi shpërthimet dhe rrezatimet e diellit, por edhe sasinë e protoneve që mbërrijnë në planetin tonë. Këto të fundit përdoren si parametër të intensitetit të aktivitetit diellor dhe sa më e lartë ka qenë dendësia dhe shpejtësia e tyre, përkon me një aktivitet më të lartë sizmik në shkallë globale. Ky vrojtim është i pari që hedh dritë mbi një lidhje kaq të drejtpërdrejtë që mund të ekzistojë mes intensitetit të aktivitetit diellor, me lëkundjet në sipërfaqen e Tokës.

## BARSOLETA E DITËS



**Policët**

**- A ke dëgjuar që në Marks ka njerëz?**
**- E para, nuk thuhet Marks. E dyta, ajo se ka njerëz atje, është vetëm hipotenuzë.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

FOTO E DITES




Radhë të gjata në pikën kufitare të Kakavijës, Shqipëri. / LSA/



E jashtëzakonshme

# Fotografi "ngrin" mediat sociale me fotografinë e "krijesës së paidentifikuar

Një fotografues ka "ngrirë" mediat sociale me një foto të një "krijese të çuditshme". Në shikim të parë, shfaqjet e çuditshme të fotografive duket se tregojnë një krijesë me fytyrë të gjatë me hundë dhe veshë të ngjashëm me gjunjë, por a mund ta dalloni iluzionin e thjeshtë? Kthimi i fotografisë 90 shkallë zbulon se, në fakt, është një kastor që rrëshqet nëpër ujë. Përdoruesit e "Facebook"-ut ishin lënë të shqetësuar nga fotografia, e bërë nga entuziasti i fotografisë së kafshëve të egra Barry Edvard pranë Lifton në Devon. Supozime të ndryshme janë rrokullisur se çfarë mund të jetë krijesa përfshirë një furçë tualeti dhe një flutur. Fotografi Barry, 64-vjeçar, ka thënë se ishte "qesharake" për t'i lexuar reagimet e njerëzve. Barry ka thënë se as nuk e ka kuptuar iluzionin optik të krijuar nga simetria e përsosur në ujë derisa është kthyer në shtëpi më vonë dhe po shikonte përsëri përmes fotove.



**DASHI**
Një ditë disi e vështirë duket kjo e nesërmja në të cilën nuk do të jeni në gjendje të mbani ritmet tuaja të zakonshme.



**DEMI**
Duke pasur një numër yjesh të favorshëm, nesër mund të jetë një ditë e mbarë në planin ekonomik, sidomos për ata që kanë mundësi të investojnë kapitalet.



**BINJAKËT**
Aktiviteti yjor në qiellin tuaj do të jetë shumë intensiv, duke bërë që edhe dita juaj të jetë shumë e ngjeshur, si në aspektin e punës ashtu edhe në atë sentimental.



**GAFORRJA**
Marsi në një pozicion dominues, nuk mund t'ju bëjë tjetër veçse agresivë e arrogantë, por duhet të bëni shumë përpjekje për të ruajtur vetëkontrollin.



**LUANI**
Me afrimin e javës shtohet edhe aspekti tjetër i karakterit tuaj, që është melankolia dhe gjendja jo e mirë shpirtërore.



**VIRGJËRESHA**
Një ditë me dy pamje, pritet të jetë kjo e nesërmja për shumë nga ju që i përkisni kësaj shenje. Një pjesë e parë e ditës ku mezi do të lëvizni, ndërsa në pjesën e dytë bëheni të papërmbajtshëm.



**PESHORJA**
Saturni dhe deri diku edhe Afërdita në orbitë nesër janë aleatët tuaj, ku veçanërisht planeti i dashurisë do të stimulojë krijueshmërinë dhe fantazinë tuaj.



**AKREPI**
Në përgjithësi problemet që ju dalin mund të jenë disa, por nuk janë aq të komplikuara, por kohët e fundit se ç'keni një prirje për të hiperbolizuar edhe gjërat më të parëndësishme.



**SHIGJETARI**
Me kalimin e ditëve duket se do kthjellohet edhe qielli juaj, pas kaq e kaq zymtësi në ditët e shkuara. Përfitoni nga hyrja e ngadaltë, por e sigurt e Jupiterit, për të rifituar shkëlqimin e humbur.



**BRICJAPI**
Me pak përpjekje më shumë mund ta kaloni edhe një ditë me probleme të vogla, por duhet të tregoni kujdes, sepse Hëna nesër mund të sjellë luhatje në humorin tuaj.



**UJORI**
Nuk duhet t'ia lini gjithçka yjeve e aq më pak rastësisë për të zgjidhur problemet tuaja imediate. Sidomos në planin sentimental, ku situatat mund të precipitojë.



**PESHQIT**
Një e diel jo shumë e favorshme për ju. Do e ndjeni veten pa energji dhe nuk keni dëshirë të dilni. Kjo lodhje vjen nga puna dhe problemet. Duhet të ndryshoni, provoni angazhimin qytetar.

# Rita Ora me të dashurin në resortin luksoz në Korfuz






Këngëtarja shqiptare, Rita Ora, ka qenë mjaft e përfolur javët e fundit në media. Paparacët kapën shumë fotografi të saj gjatë pushimeve në Ibiza me shoqërinë dhe të dashurin e ri, Romain Gavras. Tani pas disa ditëve të mira të kaluara së bashku në brigjet spanjolle, këngëtarja dhe shoqëria e saj bashkë me të dashurin e ri kanë vendosur që të ndërrojnë destinacion. Të shtunën në disa fotografi të publikuara në rrjetin social "Instagram", 29-vjeçarja ka bërë me dije se ndodhej në ishullin Korfuz të Greqisë. Prania e saj nuk mund t'i shpëtonte edhe vëmendjes së mediave greke. Lajmin për praninë e saj në Korfuz, "Protothema" e ka renditur si të katërtin më të rëndësishëm në faqe, ndërsa gjatë raportimit e kanë parë të tepërt që të përmendin faktin se ajo është shqiptare.



# Demi Rose s'i lë vend imagjinatës me imazhet e fundit

Demi Rose nuk është duke i kursyer ndjekësit në rrjetet sociale. Ajo ka publikuar një seri imazhesh të reja me të cilat ka joshur ndjekësit e saj të shumtë në rrjetin social "Instagram".

Modeluesja, e cila ka lindur në Britani, ka ikur për disa ditë pushime në Ibiza, prej nga ka ndarë disa foto në bikini ku në fokus vë të pasmet gjigante. "Perëndimi i diellit është koha ime e preferuar brenda ditës", ka shkruar Demi sipër imazheve provokuese.

# Kylie Jenner provokon ndjekësit me poza të reja nga pushimet



Kylie Jenner ka provokuar keq ndjekësit në rrjetet sociale. Ajo është duke i shijuar pushimet në bregdet dhe kohë pas kohe ndan imazhe të ndryshme me ndjekësit në "Instagram" dhe sigurisht, si çdoherë, po tërheq vëmendjen me paraqitjen. Kylie së fundmi i ka publikuar disa foto ku shfaqet në bikini dhe duket tejet joshëse. Format e saj trupore bien në sy.

# Chrissy Teigen tregon se ka qenë shtatzënë gjatë transplantimit të gjirit



Chrissy Teigen dhe këngëtari John Legend janë në pritje të fëmijës së tyre të tretë, shkruajnë mediat e huaja. Sipas medieve, shtatzënia ka qenë e paplanifikuar dhe çifti e ka marrë vesh përpara operacionit që do t'i nënshtrohej Chrissy. Pasi është pyetur nga një fans në rrjetin social 'Twitter', Chrissy ka vendosur të tregojë sesi e ka marrë vesh lajmin. "Bëra testin e shtatzënisë para se të hyja në operacion. Tregonte se është negative. U bënë shumë vite që unë bëj testin e shtatzënisë pothuajse çdo muaj, duke u lutur që një ditë të jetë pozitiv. Fatmirësisht, ashtu doli. Nuk kam pasur asnjë pozitiv më parë", ka thënë ajo. Po ashtu, Chrissy ka treguar se ka pasur frikë se mos i ndodhte diçka gjatë transplantimit të gjirit.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Sot dihet klubi im i ri, është nga mesi i tabelës

Futbollisti i njohur Albutrint Morina ka bërë me dije se sot (e hënë) do të prezantohet në klubin e ri, por ka refuzuar ta bëjë publik emrin e tij. "Kam vendosur për të ardhmen. Të hënën do të bëhet publike skuadra ime e re. Jam i kënaqur me kushtet e ofruara, por emrin e klubit nuk mund ta zbuloj për hir të korrektësisë. Krejt çfarë mund të them tash është se është klub i mesit të tabelës", ka thënë Morina

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Mesfushori Albutrint Morina do të prezantohet sot (e hënë) në klubin e ri. I kontaktuar të dielën nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", futbollisti Morina nuk pranoi ta tregojë skuadrën me të cilën ka arritur marrëveshje për shkak të korrektësisë ndaj klubit të ri. "Kam vendosur për të ardhmen. Të hënën do të bëhet publike skuadra ime e re. Jam i kënaqur me kushtet e ofruara, por emrin e klubit nuk mund ta zbuloj për hir të korrektësisë. Krejt çfarë mund të them tash është se është klub i mesit të tabelës", ka thënë Morina.

Në gjashtë muajit e fundit Morina ishte pjesë e Llapit, por në këtë klub nuk pati shumë hapësirë. I pyetur se pse nuk do të jetë edhe më tutje pjesë e klubit nga Podujeva, Morina është përgjigjur: "Kontrata më ka përfunduar dhe vendosa për të ndryshuar. Jam i kënaqur me klubin e ri dhe besoj se do ta jap më të mirën për t'i arritur objektivat që kemi".

Albutrint Morina ishte kapiten i Vëllaznimit në të kaluarën dhe kishte formë të jashtëzakonshme me klubin kuqezi nga Gjakova, mirëpo është shprehur se nuk është momenti për t'u rikthyer në këtë klub. "Jo, nuk kishte asnjë mundësi që të rikthehem tash në skuadrën e Vëllaznimit. Ambiciet e mia nuk përputhem me ato të këtij klubi, por të ardhmes nuk i dihet dhe një ditë sërish mund të djersij fanellën kuqezi", ka deklaruar Morina, i cili për një kohë të gjatë ishte pjesë e rëndësishme e skuadrës së Feronikelit.



## SHKURT

### Trajneri Rama largohet nga Besa, rikthehet te Behari

Trajneri Miftar Rama është larguar nga Besa e Pejës, pasi e riktheu në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Rama është rikthyer në skuadrën e Beharit që bën gara në Ligën e Dytë të Kosovës në futboll. "Miftar Rama - 'Mika', pas suksesit si trajner në Besën e Pejës, inkuadrimit në Superligën e Kosovës, rikthehet në Vitomiricë ku ishte në edicionin 2018/19. FC Behar nën drejtimin e trajnerit Rama, synim do ta ketë inkuadrimin në Ligën e Parë", thuhet në njoftimin e FC Behari.

### Rashica nuk e dëshiron kalimin tek Aston Villa

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Milot Rashica, duket se nuk preferon kalimin te skuadra angleze, Aston Villa. Sipas raportimeve të 'DeichStube', Rashica nuk dëshiron t'i bashkohet kësaj skuadre, pasi nuk është gati për një tjetër luftë për mbijetesë. Lojtari thuhet të kërkohet edhe nga RB Leipzig, por ky i fundit nuk po e kënaq Werderin me shifrën që ofron për kartonin e Milotit. Rashica aktualisht është në Austri, ku po qëndron me Werder Bremenin në një kamp stërvitor.

### Hamiltoni fiton Çmimin e Madh të Spanjës

Lewis Hamiltoni ka fituar Çmimin e Madh të Spanjës, me Max Verstappen, që ka arritur të rezistojë dhe ta sigurojë vendin e dytë. Valtteri Bottas është renditur i treti pas një starti të keq. Zhgënjen përsëri Ferrari, me Leclerc që nuk e ka mbyllur dot garën për shkak të problemeve në motor dhe Sebastian Vetteli që ka dalë në vendin e shtatë.

### Mazrekaj nuk e lë futbollin, afër kalimit te Laçi

Mentor Mazrekaj nuk e ka ndërmend të largohet nga loja e futbollit. Ofertat në adresë të tij kanë bërë që Mazrekaj ta japë edhe më tutje kontributin në futboll. "Olle" raporton se lojtari ka marrë një ofertë nga klubi i Laçit në Shqipëri, por edhe disa klube në Kosovë. Sulmuesi me shumë përvojë më parë ka luajtur me Partizanin, kurse në Kosovë ka veshur fanellën e Prishtinës, Ferizajt, 2 Korrikut dhe Llapit.

### Sadiku ndahet me Levanten

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Sadiku, tani është lojtar i lirë, pasi ka ndërprerë kontratën me Levanten, e cila ishte e vlefshme deri në verën e vitit tjetër. Sulmuesi kuqezi është një lojtar i lirë dhe mund të vendosë vetë se ku do ta vazhdojë karrierën. Sezonin e fundit Sadiku ishte i huazuar te Malaga, ndërkohë që kartonin e tij e zotëronte Levante. Megjithatë, tashmë palët kanë rënë dakord për ta mbyllur bashkëpunimin dhe sulmuesi tani do ta vazhdojë karrierën diku tjetër.

## Dovizioso triumfon në Austri, Rossi i pesti

VJENË, 16 GUSHT - Andrea Dovizioso është kthyer në podium në Austri, në një pistë të cilën ai e njeh mirë dhe ku triumfoi edhe vitin e kaluar. Një fundjavë me "qershi mbi tortë" për Dovin, i cili, pasi njoftoi lamtumirën e tij nga Ducati për sezonin e ardhshëm, e vendosi Desmosedicin para Suzukit të Mir dhe Ducatit tjetër të motorizuar të ekipit Pramac, të pilotuar nga Milner. Rossi e mbylli në vendin e pestë, që është edhe rezultati i tij më i mirë për Yamahan. Vendi i katërt për Brad Binder, i cili e nisi nga pozita e shtatëmbëdhjetë dhe qe në gjendje të rikuperonte shumë pozicione. Për "Doktorin", i cili shpëtoi mrekullisht nga aksidenti i Morbidellit, vendi i pestë mund të konsiderohet rezultat i mirë. Një garë për t'u analizuar në detaje, që "Doktori" ta provojë përmirësimin duke filluar nga fundjava tjetër, në të cilën, përsëri midis kthesave të Spielberg, ai do të synojë të ngjitet në podiumin për herë të 200 në karrierën e tij në MotoGP.

## Shaqiri: Do ta mbrojmë titullin në Premierë Ligë

Liverpool, 16 gusht - Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri është i gatshëm t'i ndihmojë Liverpoolit ta mbrojë titullin e fituar këtë sezon pas plot 30 vjetëve. Anësori nga Gjilani ka përvojë në mbrojtjen e titujve të ligës dhe është i sigurt se Liverpooli e ka etjen e nevojshme për ta fituar titullin edhe në sezonin 2020/21. "Të gjithë jemi të ngazëllyer dhe duam ta përsërisim sezonin që e patëm edicionin e kaluar. Është e vështirë, por ne do të tentojmë të arrijmë shumë gjëra përsëri dhe të fitojmë shumë ndeshje", ka thënë Shaqiri. "Ne kemi aftësi për këtë, sepse e kemi një ekip i cili është akoma i etur dhe dëshiron të fitojë shumë tituj", ka shtuar 28-vjeçari. Shaqiri shpreson se sezoni i ri do të jetë më fatlum për të dhe se do ta lejojë ta japë kontributin e vet në fushë. "Nëse je i lënduar apo nëse nuk luan, gjithmonë zemërohesh. Por unë mezi pres që të nisë ky sezon dhe ta ndihmoj ekipin gjatë gjithë kohës, në mënyrë që të kem mundësi të luaj si në sezonin e parë", ka deklaruar Shaqiri.



# Portlandi fiton ndaj Memphisit, përballet me Lakersin në 'play-off'

Orlando, 16 gusht - Përfundoi 126-122 sfida "play-in" mes Portland Trail Blazersit dhe Memphis Grizzliesit, me skuadrën nga Oregoni që fiton të drejtën për të marrë pjesë në fazën "play-off të këtij sezoni në NBA, ku që në raundin e parë e pret përplasja shumë e vështirë me Los Angeles Lakersin, ekipin që u rendit i pari në Konferencën e Perëndimit në përfundim të sezonit të rregullt.

Një përballje e hapur dhe e ekuilibruar në pjesën më të madhe të kohës, por diferencën Blazersi e bëri në periodën e fundit, ku nga -8 e mbyllën takimin me +4 pikë. Meritë të padiskutueshme në këtë takim kishte Jusuf Nurkiq, që edhe pse ishte në zi për ndarjen nga jeta të gjyshes së tij, rezultoi vendimtar poshtë koshit, sikurse e tregojnë edhe shifrat, me 22 pikë, 21 "rebounde" dhe 6 asistime. Për pjesën tjetër menduan Damian Lillard dhe CJ McCollum, respektivisht me 31 dhe 29 pikë.

Grizzlies shtrënguan dhëmbët të udhëhequr nga Ja Morant, shënuesi më i mirë i përballjes me 35 pikë, por që rezultuan të pamjaftueshme. Tashmë është kompletuar kuadri i çifteve të raundit të parë të "play-off"-it që do të nisin këtë të hënë me duelet Denver Nuggets-Utah Jazz dhe Toronto Raptors Brooklyn Nets.



**"Play-off" / Çiftet e raundit të parë**

**17.08.2020**
Denver Nuggets - Utah Jazz
Toronto Raptors - Brooklyn Nets

**18.08.2020**
Boston Celtics - Philadelphia 76ers
Los Angeles Clippers - Dallas Mavericks
